



SHOQËRIA CIVILE NË PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM NË KOSOVË



This project is funded by
the European Union



Ky publikim është hartuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe nuk reflekton domosdo mendimet e Bashkimit Evropian.

Publikuar nga: Partners Center for Conflict Management,
Autor: Anil Gashi

SHOQËRIA CIVILE NË PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM NË KOSOVË

- Raporti nga gjendja në terren –

PËRMBAJTJA:

• PARATHËNIE.....	5
• 1.0. Pasqyrë e kërcënimit të dhunës ekstremiste në Kosovë.....	6
• 2.0. Mbledhja e informatave	8
• 3.0. Lëmitë e angazhimit të OSHC-ve	9
3.1. Parandalimi dhe luftimi	9
3.2. Hulumtimi	13
• 4.0. Boshllëqet në angazhimin e OSHC-ve në çështjet specifike të P/LEDH dhe çështjet relevante për P/LEDH	14
• 5.0 Marrëdhënia ndërmjet OSHC-ve dhe qeverive kombëtare dhe komunale dhe sektorit privat	15
• 6.0. Përparësitë e OSHC-ve në zhvillimin dhe dhënien e programeve të P/LEDH-së dhe angazhimin në çështjet e politikave të P/LEDH-së	17
• 7.0. Dobësitë e OSHC-ve në zhvillimin dhe dhënien e programeve të P/LEDH-së dhe angazhimin në çështjet e politikave të P/LEDH-së	18
• Annex 1: Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) aktive në fushën e parandalimit / luftimit të ekstremizmit të dhunshëm (P/LEDH).....	20
• Aneksi II- Përkufizimet	26

PARATHËNIE

Organizatat e shoqërisë civile (OSHC) në Ballkanin perëndimor vazhdimisht nxiten të angazhohen në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm (P/LEDH) duke u përqendruar, në rend të parë në luftimin e radikalizimit që shpie në dhunë, por gjithashtu edhe në çështje më të gjera të ndërlidhura me promovimin e tolerancës, parandalimin e gjuhës së urrejtjes, pajtimin, dhe edukimin qytetar. Barrierë kryesore për zbatim efektiv të programeve për P/LEDH përbrenda Ballkanit Perëndimor mbetet mungesa e mirëkuptimit të komunitetit ekzistues lokal të cilët kanë kapacitet dhe kredibilitet për të realizuar programin e P/LEDH në nivel të komunitetit lokal.

Prandaj, është themeluar një konzorcium prej gjashtë OSHC-ve nga Ballkani Perëndimor (Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosova¹, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi, dhe Serbi) ka realizuar njëkohësisht vlerësim të gjendjes në terren (krijimin e hartës) për një varg të hisedarëve, që janë relevantë për zbatimin e veprimeve të P/LEDH. Ky publikim përmban të gjeturat nga hulumtimi për OSHC-të e identifikuara, organizatat fetare (OF) si dhe grupet formale dhe joformale të komunitetit lokal (GKL), të cilët punojnë në lëminë e P/LEDH në Kosovë dhe ofrojnë pasqyrë të cilësisë dhe potencial të marrëdhënieve të tyre me hisedarë kyç lokalë, kombëtarë dhe regjionalë nga sektori publik, qytetarë dhe të sektorit të biznesit. Krijimi i hartës është kryer duke aplikuar metodologji të fuqishme të krijimit të hartave të tilla, të aplikuara nga secili partner.

Raporti është hartuar nga një OJQ lokale në Kosovë “Qendra për studime të avancuara – FIT”, Anil Gashi, hulumtues në krijimin e hartës së OShC-ve në lëminë e P/LEDH në Kosovë

Aktualisht në Kosovë, në lidhje me aktivitetet e P/LEDH, institucionet qeveritare (Policia e Kosovës dhe agjenci të tjera të sigurisë) kanë shprehur gatishmërinë për të bashkëpunuar me të gjithë hisedarë relevantë në këtë lëmi si dhe me OSHC-të në Kosovë, të cilat po kontribuojnë përmes zbatimit të një sërë projektesh në këtë lëmi në Kosovë dhe në regjion. Fuqizimi i programeve rinore për parandalimin kundër radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në komunitete lokale, reintegrimi i grave dhe fëmijëve të kthyer, fuqizimi i programeve të rehabilitimit (përfshirë dizajnin e programeve të aftësimin profesional) për të dënuarit gjatë dhe pas lirimit nga burgu, me të cilat promovohet bashkëpunimi ndër-sektorial me qëllim të përfshirjes së sektorit privat në mbështetje dhe integrim të të kthyerve në nivel lokal.

¹ Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me RKS KB 1244/1999 dhe Opininionin e GJND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Aktiviteti është pjesë e projektit regional “Komunitetet në rend të parë: Krijimi i një qendreje të shoqërisë civile për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm – nga parandalimi tek reintegrimi!, zbatuar nga Qendra për nisma ligjore qytetare (Shqipëria), Shpresë dhe Shtëpi për Fëmijë (Bosnjë dhe Hercegovina), Partners Kosovo – Qendra për menaxhim të konflikteve, Forumi MNE (Mali i Zi), Center for Common Ground (Maqedonia), dhe Qendra Kulturore DamaD (Serbi), me mbështetje financiare të Bashkimit Evropian përmes Instrumentit për Shoqëri Civile (Civil Society Facility) dhe Programit për Media 2016-2017, Konsolidimi i Rrjeteve Tematike Regionale të Organizatave të Shoqërisë Civile.

1.0. Pasqyrë e kërcënimit të dhunës ekstremiste në Kosovë

Pas çlirimit të saj në vitin 1999, Kosova u bë vendi ideal për financimin e iniciativave, qëllimi i të cilave ishte përhapja e ideologjisë radikale për grupet e ndryshme të synuara brenda shoqërisë kosovare - me një fokus të veçantë rininë. Para çlirimit, religjioni i Kosovës u shtyp nga represioni serb². Mirëpo, me një popullsi me mungesë të institucioneve të duhura dhe me 95% myslimanë, Kosova është vendi i duhur për të promovuar parësinë e identitetit fetar. Financimi për përhapjen e ideologjisë radikale nuk është bërë në një drejtim të vetëm, kështu që është përhapur në shumë shtigje.

Kërcënimi i ekstremizmit të dhunshëm ishte një tabu në Kosovë për një kohë të gjatë. Në fakt, kushdo që mori guximin për të folur në lidhje me këtë temë për ta ngritë këtë çështje, menjëherë shpallej “tradhtar” ose “emisar i armikut”. Mirëpo, gjatë kohës kur Kosova u pa si një nga vendet me nivelin më të lartë të tolerancës fetare, grupet e ekstremizmit punonin në mënyrë aktive në realizimin e agjendës së tyre. Puna e dobët e bashkësisë ndërkombëtare (që ishte përgjegjëse për Kosovën) dhe e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në parandalimin e përhapjes së radikalizmit, bënë që Kosova të bëhej vendi me numrin më të madh të luftëtarëve të huaj për kokë banori në Evropë, të cilët i ishin bashkuar ISIS-it, organizatave të lidhura me al-Kaidën dhe grupeve të tjera radikale në Siri³. Përafërsisht 403 qytetarë të Kosovës kanë udhëtuar në Siri dhe Irak për të luftuar për ose për t’iu bashkuar ISIS-it ose Frontit al-Nusrah, prej të cilëve rreth 74 kanë vdekur⁴.

Konflikti në Siri zgjoi ndërgjegjen e fjetur të institucioneve dhe shoqërisë në Kosovë. Papritmas të gjithë filluan të mendojnë se kishte gjasa që sulmet mund të

2 Phillips, D. L. (22.022017). Ekstremizmi i dhunshëm në Ballkanin Perëndimor: Ndikimet e jashtme dhe shtytësit lokalë.

3 Kursani, S. (2015). Raporti mbi shkaqet dhe pasojat e përfshirjes së qytetarëve të Kosovës si luftëtarë të huaj në Irak dhe Siri. Prishtinë, Kosovë: Qendra e Kosovës për Studime të Sigurisë.

4 Departamenti Amerikan i Shtetit, Byroja kundër Terrorizmit dhe Luftimit të Ekstremizmit të Dhunshëm. (2018). Raportet e Vëndit mbi Terrorizmin 2017.

ndodhin edhe në Kosovë. Në vitin 2015, në YouTube një video nga një shqiptar i Maqedonisë, që i ishte bashkuar ISIS-it, qarkullonte në YouTube, duke deklaruar se: “Ditë të zeza po vijnë për ju ... Do të keni frikë të ecni nëpër rrugë. Do të keni frikë të punoni në zyrat tuaja ... Do t’ju vejmë frikën dhe t’ju terrorizojmë edhe në ëndrrat tuaja, teksa jeni në gjumë ... kjo do të ndodhë shumë shpejt”. Nuk kishte kaluar as edhe një vit, kur në verën e vitit 2016, më shumë se dyzet persona u plagosën gjatë manifestimit Beer Festit, ndërsa pjesëmarrësit i kaploi paniku, duke krijuar tollovi kur dikush bërtiti “ISIS” dhe gjuajti një armë të rreme⁵. Që atëherë, u arrit një mirëkuptim i përbashkët se ekstremizmi i dhunshëm është një kërcënim për Kosovën. Sipas Barometrit të Sigurisë së Kosovës, rreth 75% e të anketuarve konsiderojnë se ekstremizmi i dhunshëm është një kërcënim për shoqërinë e Kosovës. Mirëpo, vetëm 25% besojnë se ekstremizmi me bazë fetare është një kërcënim⁶.

Bazuar në informatat e mbledhura nga aktorë të ndryshëm në fushën e P/LEDH, ku shumica e tyre janë organizata të shoqërisë civile (OSHC), mund të vlerësohet se ekziston një opinion i përgjithshëm se Kosova kërcënohet nga ekstremizmi i dhunshëm. Sipas përgjigjeve të të intervistuarve, kërcënimi më i madh vjen nga ekstremizmi i dhunshëm i bazuar në fe. Nga 403 kosovarë që i janë bashkuar organizatave terroriste, rreth 133 prej këtyre individëve janë kthyer⁷. Një numër i konsiderueshëm i tyre janë dënuar ose po presin gjykim në paraburgim. Përveç luftëtarëve të huaj të kthyer, ka edhe imamë që janë dënuar për përhapjen e ideologjisë radikale. Teksa qëndrojnë në burg, ekziston frikë e vërtetë se të dy grupet mund të nxisin më tej ekstremizmin dhe radikalizmin e dhunshëm. Kjo ka ndryshuar perceptimin e publikut se kërcënimi i ekstremizmit të dhunshëm është nga jashtë, por tani ekziston frika se burgjet po shërbejnë si vend i ri, ku ideologjia radikale dhe ekstreme do të promovohet.

Duhet të theksohet se aktualisht ekstremizmi dhe radikalizimi i dhunshëm nuk është një “temë e nxehtë” për publikun, ashtu siç ishte në dy deri tre vjet të fundit, dhe as nuk ka vëmendjen që ka pasur nga donatorët ndërkombëtarë. Mirëpo, një nga të intervistuarit tanë, i cili rastisi të jetë një imam, deklaroi se: “Kjo është qetësia para stuhisë. Çdo ditë e vetme që humbim, duke mos punuar në mënyrë aktive në parandalim, individët e radikalizuar punojnë në promovimin e fenomenit”. Ai shtoi se duhet të bëhet më shumë punë nga institucionet e sigurisë në Kosovë. Një tjetër i intervistuar, drejtor ekzekutiv në një nga organizatat që ka buxhetin më të madh për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, deklaroi se: “Edhe nëse të gjitha OJQ-të e Kosovës janë të angazhuara në parandalimin e ekstremizmit

5 Polden, J. (2016). Dyzet persona u plagosën teksa pirësit i kaploi paniku në një festival birre, kur dikush bërtiti “ISIS” dhe shkrep një armë të rreme.

6 Kelmendi, V. (2018). Edicioni Special i Barometrit të Sigurisë së Kosovës: Perceptimi i qytetarëve dhe reagimi i komunitetit lidhur me luftëtarët e huaj të kthyer (Rep. Nr. 05/2018). Prishtinë, Kosovë: Qendra e Kosovës për Studime të Sigurisë.

7 Departamenti Amerikan i Shtetit, Byroja kundër Terrorizmit dhe Luftimit të Ekstremizmit të Dhunshëm. (2018). Raportet e Vendit mbi Terrorizmin 2017.

të dhunshëm, financimi i radikalizimit dhe i ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë është aq i madh, sa që do të jetë e pamundur që ta ndalojmë atë. Prandaj, Qeveria e Kosovës, së pari, duhet të zbatojë në mënyrë efikase strategjinë për parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizimit të dhunshëm, dhe vetëm atëherë ne mund të bëjmë një punë më efektive në parandalimin. Është e pamundur të parandalohet ekstremizmi i dhunshëm me ndonjë aktivitet, nëse dikush tjetër është duke ia shpërlarë trurin rinisë, dhe po ashtu i stimulon ata me pagesa në të gatshme”. Reagime të tilla ishin të zakonshme nga shumë të intervistuar, të cilët besojnë se institucionet e sigurisë duhet të bëjnë shumë më tepër, përndryshe puna e OSHC-ve nuk do të sjellë rezultatet e duhura. Një nga të intervistuarit nga Gjilani, një nga qytetet që konsiderohet si “pikë e nxehtë” e radikalizimit, na tha se ka më shumë se një vit që kur ai nuk hyn në xhami gjatë namazit të së premtes, për shkak të frikës se do të ndodhë ndonjë sulm. Duhet të theksohet se ka pasur organizata që deklaruan se nuk kanë mendim nëse Kosova kërcënohet nga ekstremizmi i dhunshëm apo jo pasi ata punojnë vetëm në parandalim dhe nuk duan të japin ndonjë përfundim për diçka që ata nuk janë të sigurt. Mirëpo, mund të konstatohet se në bazë të përgjigjeve të të intervistuarve tanë, shumica e tyre besojnë se Kosova përballet me një kërcënim të vazhdueshëm nga ekstremizmi i dhunshëm.

2.0. Mbledhja e informatave

Raporti i përpilimit të hartës bazohet në të dhënat primare dhe sekondare të mbledhura nga Qendra për Studime të Avancuara FIT gjatë periudhës korrik-shtator 2018. Gjatë fazës së hulumtimit, Qendra FIT identifikoi hisedarët e nevojshëm për të hartuar raportin, ku përfshiheshin: organizatat e shoqërisë civile, organizatat e besimit, donatorët ndërkombëtarë, përfaqësuesit qeveritarë, organizmat ndërkombëtarë dhe organizatat ndërkombëtare.

Lista e hisedarëve përfshinte: njëzet e tetë (28) OSHC; organizata fetare (OF); Koordinatori Kombëtar për Parandalimin e Ekstremizmit dhe Radikalizimit të Dhunshëm (PERDh); Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE); Ambasada Amerikane; Ambasada Britanike; Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP); Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM); Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë; mekanizmi referues në Komunën e Gjilanit; përfaqësuesit e Bashkësisë Islame të Kosovës (ICK); dhe një klub studentësh brenda Institutit Rochester të Teknologjisë në Kosovë (RIT-K).

Çdo hisedar u kontaktua nga Qendra FIT për t'u informuar lidhur me qëllimin e përpilimit të hartës. Gjithashtu, Qendra FIT ka kërkuar takime me secilin hisedar për të diskutuar për punën e tyre të mëparshme dhe aktuale në terren, por edhe për të marrë perspektivën e tyre se çfarë ndërhyrje duhet të bëhet në të ardhmen e afërt. Qendra për Studime të Avancuara FIT, arriti të takohet me shumicën

e hisedarëve të synuar. Mirëpo, ka pasur organizata të shoqërisë civile që shpjeguan se ata punojnë në terren, por nuk janë të interesuar të profilizohen si një organizatë që punon në lëminë e P/LEDH; gjithashtu, ka pasur organizata / institucione që nuk i përgjigjen fare ftesës.

Qendra FIT vazhdoi punën duke mbledhur dhe analizuar të dhënat sekondare përmes raporteve të ndryshme lidhur me parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm, duke përfshirë: Masa e Perceptimit Publik në lidhje me Kërcënimet e Ekstremizmit të Dhunshëm në Kosovë; Faktorët nxitës dhe tërheqës për ekstremizëm të dhunshëm nga kosovarët; Harta e Gjendjes lidhur me përfshirjen e institucioneve dhe komuniteteve në luftimin e ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë; Analiza e Pulsit Publik për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë, etj.

3.0. Lëmitë e angazhimit të OSHC-ve

Puna e organizatave të shoqërisë civile (OSHC), të cilat i intervistoi Qendra për Studime të Avancuara FIT, mund të ndahet në dy kategori dhe në nënkategori të ndryshme, siç janë përshkruar më poshtë:

- parandalimi dhe luftimi i ekstremizmit të dhunshëm;
 - a) angazhimi i të rinjve në proceset e vendimmarrjes,
 - b) ngritja e shkathtësive të mendimit kritik kreativ,
 - c) angazhimin e të rinjve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK)
 - d) trajnimi për ndërmarrësi,
 - e) rritja e vetëdijes për rreziqet e ekstremizmit dhe radikalizimit të dhunshëm,
 - f) puna e drejtpërdrejt me prindërit për të rritur vetëdijen e tyre, lidhur me shenjat dhe sjelljet që mund të tregojnë radikalizimin,
 - g) krijimin e klubeve sportive dhe sigurimin e pajisjeve sportive për shkollat,
 - h) ofrimin e granteve të vogla për iniciativat lokale, organizatat me bazë në komunitet, ose OJQ-të lokale.
- hulumtimi mbi ekstremizmin e dhunshëm.

3.1. Parandalimi dhe luftimi

Sa i përket lëmive të P/LEDH, në të cilat OSHC-të, janë më aktive, dhe në të cilat rajone ato kontribuojnë, kjo çështje përcaktohet në mas të madhe nga vetë donatorët, pasi OSHC-të, janë vetëm zbatuesit e objektivave të tyre. Pjesa më e madhe e organizatave të shoqërisë civile (OSHC), të intervistuar nga Qendra për Studime të Avancuara FIT, të cilat punojnë në P/LEDH të fokusuar në parandalim, janë të përqendruara veçanërisht tek të rinjtë. Duhet të theksohet se disa nga

organizatat e shoqërisë civile, janë të angazhuara në më shumë se një fushë specifike të P/LEDH.

Përfshirja e të rinjve në proceset e vendimmarrjes: Organizatat e shoqërisë civile (OSHC), siç janë Community Building Mitrovica (CBM), Këshilli Rinor Kosovar (KRK) dhe LIZA-R, janë disa nga organizatat që punojnë aktivisht në përfshirjen e të rinjve kosovarë në proceset vendimmarrëse. CBM aktualisht është duke realizuar një projekt të financuar nga Fondi Global për përfshirjen e të rinjve dhe aftësinë ripërtëritëse të komuniteteve (GCERF), ku njëri prej pikësnyimeve është përfshirja e individëve nga Mitrovica të moshës 19-24 vjeç, për hartimin e Strategjisë së Komunës së Mitrovicës për Zhvillimin e Rinisë. Përveç kësaj, projekti parashihet përfshirjen e të rinjve të Mitrovicës në hartimin e ndryshimeve në planprogramin shkollor, i cili do të përfshijë materiale, qëllimi i të cilave është ngritja e vetëdijes së nxënësve për rreziqet që dalin nga radikalizmi.

Këshilli Rinor Kosovar (KRK), trajnon këshillat e studentëve në shumë shkolla në Kosovë se si të jenë qytetarë aktivë dhe si të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes. Disa prej temave të trajnimit ishin avokimi dhe lobimi. Gjatë trajnimeve, ata shtjellojnë rëndësinë e avokimit dhe lobimit dhe si përmes këtyre formave nxënësit, mund të rrisin ndërgjegjësimin mbi rolin e tyre të vlefshëm dhe si të bëjnë ndryshime pozitive brenda shkollave të tyre. KRK-ja në mënyrë të veçantë fokusohet në procesin e hartimit të ankesave, ku secili nga studentët mund ta përdorë këtë njohuri për të shkruar një ankesë profesionale.

LIZA-R, është një tjetër organizatë që punon në rajonin e Anamoravës në Kosovë për krijimin e një brezi të ri udhëheqësish. Puna e tyre përqendrohet kryesisht në integrimin e të rinjve në proceset vendimmarrëse duke filluar nga niveli i shkollës, qeverisjes lokale dhe vazhdon deri tek pushteti qendror.

Ngritja e shkathtësive të mendimit kritik kreativ: Një fushë tjetër, në të cilën organizatat e shoqërisë civile kontribuojnë ndjeshëm, është ngritja e aftësive të mendimit kritik në mesin e të rinjve kosovarë. Organizatat e shoqërisë civile si Partners Kosova, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (KCSS), S'bunker, Organizata për Zhvillim Civil (CDO) dhe Qendra për Studime të Avancuara FIT, janë disa nga organizatat që punojnë në këtë fushë. Kjo punë është e ndarë në dy kategori: ato që punojnë drejtpërdrejt në temën e P/LEDH dhe ato që punojnë në mënyrë indirekte.

Në kategorinë e parë, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë organizon debate mendimit kritik me nxënës të shkollave të mesme, qëllimi i të cilave është të informojnë nxënësit e rinj rreth dukurisë së dhunës ekstremiste dhe të theksojë rolin e tyre në parandalimin e fenomenit. Grupet në përbërje të

nxënësve diskutojnë tema të ndryshme që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm, paraqesin gjetjet e tyre për grupe të tjera dhe përfshihen në debat mbi këto tema. Nëpërmjet aktiviteteve të tilla, QKSS synon të përfshijë nxënësit e rinj në platforma të zhvillimit të mendimit kritik ndaj dukurive të ndryshme që mund të hasin në komunitetin e tyre⁸. Partners Kosova, gjithashtu punon me të rinjtë, duke zhvilluar seminare interaktive me shkollat e mesme me synim krijimin e zërave të besueshëm nëpërmjet ndërtimit të besimit, në mënyrë që të ndikojnë në ndryshimin e qëndrimit “të heshtjes” së komunitetit në raport me radikalizimin.

Për dallim nga dy organizatat paraprake, organizatat e shoqërisë civile, si Qendra për Studime të Avancuara FIT dhe Organizata për Zhvillimin Qytetar (CDO), kanë themeluar “Klubet e Debatit” brenda shkollave dhe aftësojnë nxënësit se si të debatojnë në formatin Karl Popper. Qëllimi i themelimit të klubeve dhe trajnimeve ishte ngritja e aftësive të mendimit kritik tek të rinjtë, të cilat do të shërbenin si mjet për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm; mirëpo, e gjithë kjo punë është bërë pa përmendur fare fjalët “ekstremizëm i dhunshëm”. Gjithashtu, S'bunker ka themeluar programe të mendimit kritik, ku në mënyrë interaktive diskutojnë me të rinj tema të ndryshme, me interes për të rinj, dhe bëjnë analiza kritike.

Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit: Organizatat e shoqërisë civile, si Open Data Kosovo (ODK) dhe Fondi për Zhvillim Komunitar (CDF), punojnë në projektet P/LEDH që përfshijnë Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK). Open Data Kosovo (ODK) ka realizuar projektin «Luftimi përmes teknologjisë». Projekti kontribuon në P/LEDH, në mesin e të rinjve në Komunën e Gjilanit, duke i përfshirë ata në punëtoritë e TIK, duke rritur punësueshmërinë e bazuar në aftësi, duke përmirësuar kapacitetin e tyre për mendim kritik dhe duke rritur vetëbesimin e tyre, duke u mundësuar kështu që të shprehin më mirë mendimet e tyre dhe të bëhen pjesëmarrës aktivë në hartimin e politikave. Projekte të tilla synojnë: t'u ofrojnë të rinjve aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të kontribuar në komunitetin lokal dhe për të zhvilluar platforma për nevojat e rinisë; të përmirësojnë kompetencat profesionale të TIK-ut për rininë; të identifikojnë nevojat dhe çështjet që kërkojnë zgjidhje digjitale; të rrisin punësueshmërinë e studentëve dhe të ulin gjasat e radikalizimit.⁹ Gjithashtu, një program i financuar nga GCERF - Ndërtimi i elasticitetit për komunitete dhe individë në Kosovë (BRICK), i realizuar nga Fondi për Zhvillim e Komunitetit (CDF) dhe partnerët e tij, ofron trajnim për TIK për nxënësit e shkollave të mesme në Komunën e Kaçanikut. Ndërtimi i elasticitetit për komunitetet dhe individët në Kosovë, është një program i zhvillimit të studentëve, bazuar në kornizën bashkëkohore për Zhvillimin Pozitiv të Rinisë.

Ndërmarrësia (duke përfshirë sipërmarrjen sociale): Besohet se përgatitja e të rinjve të Kosovës, për t'u bërë sipërmarrës të ardhshëm, është një nga mënyrat

⁸ Rinia në veprim - debati i mendimit kritik në komunën e Obliqit (n.d.). Kosovë: Qendra e Kosovës për Studime të Sigurisë
⁹ Luftimi përmes teknologjisë (n.d.). Open Data Kosovo.

efektive për P/LEDH. OSHC-të e përfshira në këtë fushë, përfshijnë Forumin për Iniciativa Qytetare, i cili po trajnon rininë e Komunës së Kaçanikut për sipërmarrjet sociale. Qendra e Kosovës për Përkrahjen e Biznesit (KCBS), po ofron trajnime të ngjashme për të rinjtë në Prishtinë, Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë dhe në Prizren; dhe CDF ofron trajnime mbi ndërmarrësinë për nxënësit e shkollave të mesme në Kaçanik. Megjithatë nuk është përfitues i financimit “P/LEDH”, Qendra e Inovacionit Jakova, e cila punon si inkubator biznesi, me misionin të promovojë dhe mbështesë sipërmarrësit e rinj në ndërtimin dhe zhvillimin e kompanive të reja, po kontribuon në P/LEDH në Komunën e Gjakovës.

Angazhimi me nxënësit / ngritja e vetëdijes: Një numër i OSHC-ve, janë aktiv në këtë lëmi. Për shembull, Iniciativa Qytetare në Skenderaj dhe Demokracia Plus (D+), diskutojnë me studentët rreziqet dhe pasojat që sjell ekstremizmi i dhunshëm në jetën e të rinjve. Iniciativa Qytetare në Skenderaj ka angazhuar një sociolog nga Universiteti Ludwig Maximilian i Mynihut për të angazhuar nxënësit e shkollave të mesme në këtë komunë, lidhur me rëndësinë e tolerancës fetare dhe rreziqet dhe pasojat e ekstremizmit të dhunshëm. Përveç kësaj, Demokracia Plus (D+), është duke hartuar një doracak për të rinjtë lidhur me pasojat e ekstremizmit të dhunshëm, i cili do të prezantohet në pesë komuna (Prishtinë, Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë dhe Prizren).

Puna me prindërit: Organizatat si Iniciativa e Gruas Kosovare (KWI), punojnë drejtpërdrejt me nënat në rajonin e Gjakovës, përfshirë edhe prindërit, dhe u ndihmojnë të kuptojnë dhe identifikojnë më mirë sjelljet dhe shenjat tek fëmijët e tyre, të cilat mund të vejnë në dukje radikalizimin e dhunshëm. Demokracia Plus (D+), është duke hartuar një doracak për prindërit, i cili do t'i udhëzojë ata se si t'i mbrojnë fëmijët nga radikalizimi dhe ekstremizmi i dhunshëm.

Organizatat e shoqërisë civile, janë të përfshira në punë të tjera parandaluese të lidhura me P/LEDH. Në shumicën e këtyre rasteve, ato mbështeten edhe nga organizatat ndërkombëtare. Aktivitete të tilla përfshijnë, për shembull,

- Ofrimin e granteve të vogla për iniciativat lokale, organizatat bazë, ose OJQ-të lokale që synojnë përmirësime në komunitet;
- ofrimin e seminareve të vetëdijesimit mbi sigurinë në internet për nxënësit, mësuesit dhe prindërit;
- monitorimin dhe raportimin e aktiviteteve të grupeve të mediave sociale që promovojnë ideologji radikale;
- krijimin e materialeve edukative për mësuesit se si t'i mbrojnë nxënësit nga radikalizimi dhe ekstremizmi i dhunshëm;
- ngritja e kapaciteteve profesionale dhe njohurive të mediave dhe gazetarëve në nivel lokal për çështjet që lidhen me ekstremizmin, radikalizimin dhe terrorizmin e dhunshëm;

- organizimin e trajnimit për gazetarët e të gjitha komunave të Kosovës për raportimin, analizimin e çështjeve që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm, radikalizmin dhe terrorizmin;
- trajnimin i trajnerëve për të rinjtë nga komunitetet fetare lidhur me të drejtat e njeriut, tolerancën dhe lirinë e fesë;
- mbajtjen e forumit rinor ndëretnik lidhur me rëndësinë e dialogut ndërmjet komuniteteve për të adresuar të kaluarën, njëanshmërinë, paragjykimet dhe diskriminimin.

Edhe pse pjesa më e madhe e angazhimit të shoqërisë civile në P/LEDH në Kosovë, fokusohet në parandalimin, disa OSHC po punojnë në “rrjedha të mëposhtme”, p. sh. me ata që kthehen nga zonat e konfliktit në Irak dhe Siri.

Për shembull, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), me mbështetjen e Qeverisë së ShBA, po zbaton një projekt që synon zvogëlimin e kërcënimit të terroristëve të huaj dhe individëve të tjerë të radikalizuar në Kosovë, nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve të hisedarëve të përfshirë për realizimin e kundërmesazheve dhe angazhimit në komunitet. Qëllimi përfundimtar i projektit është të përfshijë qytetarët dhe anëtarët e komunitetit në luftimin dhe parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizimit të dhunshëm në Kosovë ¹⁰. Projekti mbulon 11 komuna në Kosovë, përfshirë: Prizrenin, Pejën, Mitrovicën, Gjilanin, Ferizajin, Kamenicën, Elez Hanin, Kaçanikun, Gjakovën, Klinën dhe Deçanin. Qendra e Kërkimit të Politikave të Sigurisë (SPRC), është angazhuar në aktivizimin dhe trajnimin e organizatave me bazë në komunitet për mënyrën e luftimit të ekstremizmit të dhunshëm. Gjithashtu, ata kanë mbajtur takime të rregullta me këshillat komunalë për sigurinë në bashkësi, ku kanë diskutuar së bashku format e luftimit të ekstremizmit të dhunshëm në komunitetet e tyre.

Për luftimin e ekstremizmit të dhunshëm, ndihmë të konsiderueshme ka ofruar gjithashtu bashkësia ndërkombëtare. Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), ka ndihmuar në themelimin e një mekanizmi referimi, të pilotuar në Komunën e Gjilanit, i cili është mekanizmi i parë i Kosovës, i cili ofron mbështetje për individë në rrezik nga radikalizimi. Duhet të theksohet se krijimi dhe funksionimi i Mekanizmit Referues në Gjilan, është bërë pa përfshirjen aktive të OSHC-ve. Dhe në fund, ka një iniciativë nga Ministria e Drejtësisë (MD), për të mbajtur ligjërata për de-radikalizim në burgjet e Kosovës, me fokus në luftëtarët e kthyer të huaj. Ky proces do të zhvillohet në bashkëpunim me Bashkësinë Islame në Kosovë dhe me organizata të ndryshme të shoqërisë civile.

3.2 Hulumtimi

Organizatave të shoqërisë civile po kryejnë gjithashtu kërkime mbi ekstremizmin e dhunshëm në Kosovë. Për shembull, Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED), ishte një nga OSHC-të e para, e cila u angazhua në këtë fushë. Në vitin 2005, KIPRED-i publikoi një raport - "Islami Politik në mesin e Shqiptarëve: A po vijnë talebanët në Ballkan?"¹¹. Në vitin 2016, ata botuan një studim tjetër me titull "Çfarë ndodhi me shqiptarët e Kosovës: Ndikimi i fesë në identitetin etnik në periudhën e shtet-ndërtimit". Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), ka kryer studime të ndryshme kërkimore mbi faktorët tërheqës dhe nxitës të ekstremizmit dhe radikalizimit të dhunshëm në Kosovë; perceptimet e qytetarëve për ekstremizmin e dhunshëm; qëndrimet e qytetarëve kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit në Kosovë; gratë në ekstremizëm të dhunshëm. Qendra për Politika dhe Hulumtime të Sigurisë (SPRC), gjithashtu ka kryer hulumtime në terren, duke publikuar raportin "Faktorët që ndikojnë në radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm: mësim nga Peja, Mitrovica, Gjilani, Ferizaji dhe Kaçaniku".

4.0. Boshllëqet në angazhimin e OSHC-ve në çështjet specifike të P/LEDH dhe çështjet relevante për P/LEDH

Siç u diskutua në seksionet e mëparshme, një numër organizatash të shoqërisë civile (OSHC), janë të angazhuara në P/LEDH në Kosovë. Organizatat e shoqërisë civile gjithashtu ofrojnë mbështetje institucionale - veçanërisht duke kontribuar në hartimin e «Strategjisë për parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizimit të dhunshëm që çon në terrorizëm 2015-2020». Bazuar në vlerësimin tonë, parandalimi dhe luftimi i ekstremizmit të dhunshëm është i mbuluar mirë nga ana e shoqërisë civile. Megjithatë, ekziston një hendek i rëndësishëm në regjionet që mbulohehen nga organizatat e shoqërisë civile.

Projekti i organizatave të shoqërisë civile përqendrohet kryesisht në "pikat e nxehta" të radikalizimit dhe në lëmitë ku kërcënimi i ekstremizmit të dhunshëm është më i lartë - OSHC-të arsyetojnë se kjo ndodh bazuar në kërkesën e donatorëve për t'u fokusuar në zona të cenueshme. Për shembull, trajnimi për ndërmarrësi, shoqëruar me grante të vogla për iniciativat lokale, kryesisht përqendrohet në komunën e Kaçanikut, e cila njihet si një nga vendet me numrin më të madh të luftëtarëve të huaj që janë bashkuar ISIS-it. Iniciativat e tilla janë shumë të mirëpritura nga banorët e kësaj zone; mirëpo, bazuar në një vlerësim në terren të cilën e ka realizuar Qendra FIT në vitin 2017, kjo krijon pakënaqësi tek qytetarët e zonave të tjera, siç është Podujeva, e cila gjithashtu kishte pjesëtarë të komunitetit të tyre të cilët kanë udhëtuar në zonat e konfliktit në Siri dhe Irak. Edhe pse Podujeva nuk ka ndonjë luftëtar të huaj, megjithatë ka vërejtur një

¹¹ Blumi, I. (2005). 'Islami Politik në mesin e shqiptarëve: A po vijnë talebanët në Ballkan? Botimi i dytë', KIPRED: Prishtinë,

rritje të numrit të njerëzve me pikëpamje radikale. Prandaj, ekziston një boshllëk në angazhimin e OSHC-ve në zona specifike, por mund të konsiderohet se në “pikat e nxehta”, situata është e mbuluar mjaft mirë. Duhet të theksohet se një boshllëk tjetër është se pjesa dërrmuese e angazhimit të OSHC-ve, është në anën e parandalimit të çështjes, me përfshirjen jashtëzakonisht të kufizuar të OSHC-ve në arenën e intervenimit / rehabilitimit / riintegrit.

5.0 Marrëdhënia ndërmjet OSHC-ve dhe qeverive kombëtare dhe komunale dhe sektorit privat

Koordinatori kombëtar i Kosovës për PEDh/R (Parandalimi i Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmi), qëndron në Zyrën e Kryeministrit. Ai është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të strategjisë kombëtare për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, i cili parasheh qasjen e shumë palëve të interesuara ndaj kërcënimit. Sidoqoftë, deri më tash, qeveria nuk duket se ka një listë të të gjitha palëve të interesuara në Kosovë që kanë të bëjnë me P/LEDH dhe duket se nuk ekziston as ndonjë mekanizëm për të lehtësuar bashkëpunimin qeveria-OSHC në zbatimin e strategjisë PEDhH/R. Duhet të theksohet se qeveria po përpiqet të krijojë një mekanizëm që do të rregullonte çështje të tilla.

Në vitin 2017, Misioni i OSBE-së në Kosovë, filloi të zhvillojë “Bazën e të dhënave VERLT” (VERLT: Ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi që çon në terrorizëm), që do të përfshinte një bazë të dhënash të qeverive përkatëse dhe hisedarëve joqeveritarë të P/LEDH në vend. Megjithatë, kjo përpjekje, e cila kishte për qëllim mbështetjen e Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës (SKSK) të Zyrës së Kryeministrit, për të ndjekur dhe koordinuar aktivitetet e lidhura me VERLT të të gjitha palëve të interesit, partnerëve dhe organizatave mbështetëse, ka ngecur. Krijimi i bazës së të dhënave synonte të ndihmonte SKSK-në në shmangien e dyfishimeve dhe përsëritjeve të mundshme të aktiviteteve dhe t’u mundësonte atyre të prodhonin raporte më cilësore periodike për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Parandalimin e VERLT-it.

Pavarësisht nga mungesa e një mekanizmi specifik për bashkëpunim ndërmjet OSHC-ve dhe qeverisë kombëtare, zyra e koordinatorit kombëtar punon drejtpërdrejt me bashkësinë ndërkombëtare (përfshirë organizatat donatore) për të koordinuar përpjekjet e tyre në P/LEDH. Konkretisht, koordinatori kombëtar ka takim mujor me komunitetin e donatorëve në Kosovë. Përveç kësaj, zyra e koordinatorit kombëtar për PEDhH/R, kërkon raporte narrative çdo tre muaj nga organizatat e shoqërisë civile që zbatojnë projekte të një shkalle më të gjerë. Koordinator kombëtar është aktiv në monitorimin e strategjisë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, duke përfshirë monitorimin e përpjekjeve të zbatimit të ministrive të ndryshme relevante kombëtare që janë pjesë e kësaj strategjie.

Angazhimi i koordinatorit kombëtar me OSHC-të ka qenë ad hoc dhe kryesisht reaktiv. Ai është përgjigjur pozitivisht ndaj ftesave nga organizata të ndryshme të shoqërisë civile për të marrë pjesë në mbledhjet / aktivitetet e tyre dhe në kërkesat e tyre për informacion. Ai, gjithashtu ka marrë pjesë në takimin tematik “Angazhimi dhe Koordinimi i Grupeve të Interesit në Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm”, organizuar nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC). Bazuar në intervistat tona, mbështetja e qeverisë kombëtare për përpjekjet e OShC-ve, ka qenë e kufizuar në sigurimin e informacionit dhe lejes për të vepruar (p.sh. leje për zbatimin e aktiviteteve në shkolla) dhe nuk ka përfshirë ndonjë mbështetje financiare. Në tetor 2018, është krijuar një komision ndërinstytucional për trajtimin e ekstremizmit të dhunshëm nga Qeveria e Kosovës. Zyra e Kryeministrit, do të sigurojë mbështetje administrative për punën e Komisionit, i cili do të analizojë, rekomandojë dhe adresojë të gjitha çështjet që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm në Kosovë.¹²

Bashkëpunimi midis OSHC-ve dhe pushtetit lokal është i pabarabartë, pasi varet nga gatishmëria e kryetarit përkatës për të bashkëpunuar. Për shembull, në bazë të përgjigjeve të të intervistuarve tanë - deri në këtë vit, komuna e Gjakovës, nuk ka shprehur asnjë interes në P/LEDH - pasi nuk kanë besuar se ekstremizmi i dhunshëm është përhapur në këtë komunë - dhe kështu bashkëpunimi me OSHC-të në agjendë nuk ekzistonte. Megjithatë, me kryetarin e sapozgjedhur, situata ka ndryshuar në mënyrë dramatike. Në tremujorin e parë të vitit 2018, ai e bëri P/LEDH një prioritet dhe ka kërkuar të forcojë bashkëpunimin me OSHC-të lokale në këtë fushë.

Megjithëse shumica e të anketuarve tanë thanë se nuk morën ndonjë mbështetje nga qeveria lokale për zbatimin e projekteve të tyre për P/LEDH, ata vunë në dukje se autoritetet lokale nuk po pengonin zhvillimin ose zbatimin e ndonjë iniciative të P/LEDH-së të udhëhequr nga OSHC-të në komunat e tyre.

Përveç sfidave të bashkëpunimit qeveri-OSHC rreth agjendës së P/LEDH-së në Kosovë, ekziston një mungesë e koordinimit ndërmjet qeverisë kombëtare (qendrore) dhe qeverisë lokale rreth zbatimit të strategjisë kombëtare për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që çon në terrorizëm. Kjo është pjesërisht për shkak të kapacitetit të kufizuar të komunave për t'u angazhuar në këtë hapësirë. Megjithatë, po bëhen përpjekje për të adresuar këtë boshllëk: qeveria kombëtare, në partneritet me Organizatën Ndërkombëtare për Migrim (IOM), po kryen ngritjen e kapaciteteve për zyrtarët e komunës për zbatimin e strategjisë kombëtare. Ky projekt pilotohet në komunat e Prishtinës dhe Mitrovicës dhe bazuar në rezultatet, do të merret parasysh nëse kjo do të vazhdojë edhe në komunat e tjera.

¹² Zyra e Kryeministrit. (2018). Qeveria e Kosovës. Strategjia për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që çon në terrorizëm 2015-2020. Prishtinë: Kosovë.

Është mjaft i njohur fakti se shumica e kompanive në Kosovë nuk kanë aktivitete të përgjegjësisë sociale të korporatës. Prandaj, sa i përket bashkëpunimit në mes OSHC-ve dhe sektorit privat në Kosovë, duhet të theksohet se asnjëri nga të anketuarit tanë, nuk ka deklaruar se kanë marrë ndonjë mbështetje apo bashkëpunim nga sektori privat.

Së fundmi, duhet të theksohet se bashkëpunimi ndërmjet OSHC-ve në Kosovë që punojnë në çështjet e P/LEDH-së, është i kufizuar. Përveç që nuk ka rrjet ose mekanizëm tjetër për të mundësuar një bashkëpunim të tillë, OSHC-të tentojnë ta shohin njëri-tjetrin si konkurrentë (për grante) dhe prandaj hezitojnë të ndajnë ide ose përvoja të projektit.

Ekzistojnë disa indikacione se situata po përmirësohet. Për shembull, ATRC së fundmi ka organizuar OSHC-të që punojnë në hapësirën e P/LEDH-së, duke përfshirë edhe për qëllimin e shkëmbimit të përvojave, praktikave të mira dhe sfidave në zbatimin e projekteve të P/LEDH-së në vend.

Përveç kësaj, Fondi për Angazhimin dhe Resilencën e Komunitetit Global (GCERF), kohët e fundit, ka mbështetur krijimin e tre konzorciumeve të OSHC-ve, duke përfshirë më shumë se 16 OSHC-të lokale, të cilat po zbatojnë projekte të P/LEDH-it të financuara nga GCERF.

6.0. Përparësitë e OSHC-ve në zhvillimin dhe dhënien e programeve të P/LEDH-së dhe angazhimin në çështjet e politikave të P/LEDH-së

Organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të) në Kosovë, janë mjaft të angazhuara në fushën e P/LEDH-së, sidomos gjatë tre viteve të fundit, kur fenomeni u bë një nga temat më të diskutuara dhe shqetësuese në shoqërinë kosovare. Siç është theksuar më parë, OSHC-të janë angazhuar kryesisht në hapësirën e parandalimit, duke punuar në disa fusha. Përparësia më e madhe e shumicës së OSHC-ve në Kosovë, është se ata vazhdojnë të punojnë në fushën e tyre të specializuar, por e kanë lidhur atë me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Për shembull, organizatat që kanë punuar për të ndërtuar mendimin kritik për të rinjtë e Kosovës, kanë vazhduar këtë punë, por tash me qëllim parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Përveç kësaj, OSHC-të që kanë punuar në hulumtime në fushën e sigurisë, kanë vazhduar të qëndrojnë në specialitetin e tyre, por tash me fokus në hulumtimin për parandalimin/luftimin e ekstremizmit të dhunshëm. Përdorimi i përvojave të tyre të mëparshme dhe qasjes në fushat e tyre, ka forcuar OSHC-të për të ofruar një punë më cilësore për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.

Bazuar në rezultatet e donatorëve që ata kanë ndarë gjatë intervistave, OSHC-të e Kosovës, kanë qenë të suksesshme në promovimin e vlerave të caktuara siç janë harmonia fetare, angazhimi qytetar, marrëdhëniet ndëretnike etj.

Bazuar në vlerësimin tonë, një përparësi tjetër e OSHC-ve të Kosovës, është se ata janë të përgatitur të mbështesin institucionet për të krijuar politika dhe strategji më të mira për P/LEDH-të, një nga shembujt është kontributi i OSHC-ve për krijimin e strategjisë kombëtare për PEDh-në. Vlerësohet se avokimi për politika të caktuara vjen nga hulumtime dhe analiza me bazë të mirë. Përveç kontributit të tyre për krijimin e strategjisë kombëtare të PEDh-së, OSHC-të e Kosovës kanë luajtur një rol kyç edhe në zbatimin e kësaj strategjie. Angazhimi i OSHC-ve për krijimin e strategjisë kombëtare për PEDh/R-në, ka qenë vetëm me ftesë. Ndërsa kontributi i OSHC-ve për krijimin e politikave më të mira është kryesisht i bazuar në projekt (mbështetje nga një donator).

Megjithëse bashkëpunimi midis OSHC-ve në fushën e P/LEDH-së, ka qenë i kufizuar deri më sot, ku shpesh e konsideronin njëri-tjetrin si konkurrentë për fonde të kufizuara të donatorëve, angazhimi i fundit i GCERF-it në vend po krijon më shumë mundësi për bashkëpunim. Fondet e GCERF-it mbështetën krijimin e tre konzorciumeve të OSHC-ve në vend, duke përfshirë 16 OSHC-të. Këto konzorciume (ose rrjete) do të rezultojnë me një kombinim të aktiviteteve të ndryshme në terren, gjë e cila automatikisht do të sjellë vlerë të shtuar dhe do të rezultojë më e dobishme për qytetarët.

Bazuar në vlerësimin tonë, duket se OSHC-të, të cilat kanë një regjistër të punës së drejtpërdrejtë me anëtarët e komuniteteve relevante dhe kanë zhvilluar ekspertizën e kërkuar, shpesh janë më të informuar për situatën dhe janë më të pozicionuar për t'u angazhuar në nivelin lokal sesa institucionet qeveritare.

7.0. Dobësitë e OSHC-ve në zhvillimin dhe dhënien e programeve të P/LEDH-së dhe angazhimin në çështjet e politikave të P/LEDH-së

Dobësitë që rrjedhin nga fakti se OSHC-të, janë të varura nga financimi i donatorëve për projektet e tyre P/LEDH dhe u është dashur të bëjnë ndryshime gjatë zbatimit të projektit bazuar në kërkesa të donatorëve. Të intervistuarit tanë deklaruan se në shumë raste, edhe kur projekti i tyre fillimisht u përzgjedh për të marrë fonde, ka pasur ndërhyrje të mëdha në aktivitete, në mënyrë që të përshtaten me dëshirat e ndryshuara të donatorëve. Ka gjithashtu raste kur OSHC-të janë përzgjedhur për të marrë fonde për një projekt P/LEDH, mirëpo, për shkak të ndryshimeve të kërkuara nga organizata donatore në aktivitetet e tyre, OSHCja nuk ishte e gatshme të bënte ndryshimet dhe të devijonte nga objektivat origjinale të projektit dhe kështu në fund humbën edhe fondet.

Një dobësi tjetër është mungesa e financimit të qëndrueshëm të projektit. Gjatë hartimit të projekteve, shumë OSHC parashikojnë dorëzimin e përgjegjësive për zbatim tek një institucion shtetëror ose një partner tjetër, sapo të mbarojë financimi i donatorëve. Megjithatë, në shumë raste, nuk kanë mundur ta bëjnë këtë. Një shembull, është krijimi i “Klubeve të Debatit” në kuadër të shkollave të Kosovës, të cilat krijohen me ndihmën e OSHC-ve, dhe pastaj anëtarët e klubit aftësohen nga OShC-të, ku edhe krijohet një plan aktiviteti me ndihmën e OSHC-ve. Mirëpo, është e kuptueshme që një OSHC, nuk mund ta vazhdojë punën pa kufi dhe synojnë që të lërë menaxhimin e “Klubeve të Debatit” në duart e studentëve dhe administratës së shkollës, por në shumicën e rasteve këto klube të nxënësve nuk e vazhdojnë punën e tyre për shkak të mungesës me interes nga ana e shkollës.

Një dobësi tjetër është se OSHC-të, nuk janë konsultuar sa duhet me përfituesit e projektit në fazën e projekteve, të cilat mund të dëmtojnë efektivitetin e projektit. Gjithashtu, disa OSHC janë politikisht të njëanshme. Kjo posaçërisht në komunat e vogla, ku disa OSHC, janë të angazhuara në mënyrë aktive në partitë politike. Edhe pse lidhjet me një parti politike (veçanërisht me ata në pushtet), mund të lehtësojnë punën e tyre në një periudhë afatshkurtër, disa të intervistuar vunë në dukje se kjo dukshëm lehtëson punën e tyre.

Në fund fare, mungesa e mekanizmave për të lehtësuar koordinimin dhe bashkëpunimin midis OSHC-ve që punojnë në P/LEDH dhe ndërmjet OSHC-ve dhe qeverisë kombëtare (qendrore) dhe lokale, duket gjithashtu të jetë një dobësi.

Aneksi I: **Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) aktive në fushën e parandalimit/luftimit të ekstremizmit të dhunshëm (P/LEDH)**

Emri i organizatës	Fokusi gjeografik	Misioni	Ueb faqja
Instituti Columbus	Gjithë Kosova	Misioni i Institutit është të kontribuojë në krijimin e një kulture në Kosovë që promovon qytetarinë aktive në shoqëri. Instituti Columbus është një nën-përfitues i fondet të GCERF dhe roli i tij kryesor është promovimi i aktiviteteve të OSHC-ve të tjera, që janë pjesë e programit "Ndërtimi i elasticitetit për komunitete dhe individë në Kosovë (BRICK)".	www.instituticolumbus-ks.com
LIZA-R	Regjioni i Anamoravës	LIZA-R është një organizatë joqeveritare e themeluar me qëllim të integritimit, fuqizimit dhe rritjes së kapaciteteve rinore në proceset demokratike në rajonin e Anamoravës.	www.liza-r.org
Iniciativa Qytetare në Skenderaj	Skenderaj dhe Drenas	Misioni i IQS është fuqizimi i rolit të shoqërisë civile në proceset vendimmarrëse dhe ngritja e nivelit të qeverisjes lokale në Komunën e Skenderajt. IQS aktualisht është duke realizuar projektin "Edukimi i të Rinjve për Rreziqet e Ekstremizmit të Dhunshëm".	www.iqskenderaj.org
Organizata për Zhvillim Civil (CDO)	Mitrovicë, Mitrovicë e Veriut, Vushtrri, Skenderaj, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok	Qëllimi i CDO-së është të fuqizojë qytetarët e Kosovës që të ndikojnë në rritjen e transparencës, përgjegjësisë dhe llogaridhënies së institucioneve vendore dhe qeveritare. CDO aktualisht është duke realizuar një projekt lidhur me P/LEDH, që synon të ofrojë një alternativë pozitive për të rinjtë e Kosovës përmes trajnimit për debatim.	Nuk vlen
Studentët e diplomuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (KUSA)	Gjithë Kosova	Organizata respekton rreptësisht vlerat demokratike dhe diversitetin e opinionëve dhe sfondit dhe nxit diskutim dhe debat të hapur. KUSA gjithashtu shpërndan fonde në formë të granteve për organizatat jofitimprurëse ose individët që synojnë forcimin e demokracisë dhe të drejtave të njeriut në Kosovë.	www.kusaalumni.blogspot.com
Qendra Rinore "AVOKO"	Dragash	Qendra Rinore "AVOKO" është aktive në ndërtimin e paqes në Komunën e Dragashit dhe punon në mënyrë aktive në edukimin joformal të të rinjve. AVOKO zbatoi një projekt për P/LEDH me debatim me nxënësit e shkollave të mesme të ulët dhe të lartë rreth rëndësisë së tolerancës fetare.	Nuk vlen

Emri i organizatës	Fokusi gjeografik	Misioni	Ueb faqja
Forumi për Iniciativa Qytetare	Gjithë Kosova	Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ) është një fondacion kombëtar me një traditë të gjatë të punëve në zhvillim të komunitetit, për të promovuar filantropinë për zhvillim të qëndrueshëm. FIQ-i është përfituesi kryesor i fondeve të GCERF dhe do të zbatojë një projekt me fokus në sipërmarrjet sociale për të rinjtë e Kosovës.	www.fiq-fci.org
Fondi për zhvillim të komunitetit (Community Development Fund - CDF)	Gjithë Kosova	Fondi për Zhvillim të komunitetit (CDF), mbështet ngritjen e kapaciteteve institucionale në nivel të komuniteteve dhe të komunës, në mënyrë që të përmirësojë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e ofrimit të shërbimeve dhe të rrisë pjesëmarrjen qytetare në zhvillimin lokal. CDF-i është përfituesi kryesor i fondeve të GCERF dhe aktualisht po zbaton programin "Ndërtimi i elasticitetit për individët dhe komunitetet në Kosovë (BRICK)". BRICK, është një program për zhvillimin e të rinjve dhe synon zhvillimin e aftësive personale dhe profesionale të nxënësve. Qëllimi kryesor i aktiviteteve të programit BRICK, është fuqizimi i studentëve dhe strukturave të tyre ekzistuese.	www.kcdf.org
S'bunker	Gjithë Kosova	S'bunker është një blog në internet, i cili vepron si një organizatë joqeveritare që synon të ketë një efekt të drejtpërdrejtë në rindërtimin e sferës publike në Kosovë. S'bunker ka implementuar projektin P/LEDH, ku punuan me të rinjtë në Kosovë për të ngritur aftësitë e mendimit kritik kreativ.	www.sbunker.net
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë		Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë është një qendër kërkimore e pavarur. QKSS është e dedikuar në zhvillimin dhe reformën e sektorit të sigurisë në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor. Ajo promovon në mënyrë proaktive parimin e qeverisjes së mirë, integritetit dhe elasticitetit. QKSS ka "Programin e Luftimit të Ekstremizmit të Dhunshëm", i cili synon të analizojë fenomenet e dhunës ekstremiste dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në nivel komuniteti.	http://www.qkss.org

Emri i organizatës	Fokusi gjeografik	Misioni	Ueb faqja
Të dhënat e hapura Kosovë		Të Dhënat e Hapura Kosova (Open Data Kosovo), është një organizatë jofitimprurëse që beson në përdorimin e humanizmit qytetar-teknologjik dhe digjital për të hapur qeverinë. Kjo iniciativë promovon idenë se të dhënat e qeverisjes duhet të vihen lirisht në dispozicion për të gjithë për t'u përdorur dhe ripublikuar sipas dëshirës, pa kufizime ngatë drejtata autoriale, patentatose mekanizmat e tjerë të kontrollit. ODK është nën-përfituesi i fondeve të GCERF dhe ata do të zbatojnë një projekt kutë rinjtë dotë mësojnë kodimin.	www.opendatakosovo.org
Qendra e Inovacionit Jakova (Jakova Innovation Center)	Gjakova	Qendra e Inovacionit Jakova është një organizatë jofitimprurëse e themeluar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me komunën e Gjakovës. Kjo qendër shërben si një inkubator biznesi me mision promovimin dhe mbështetjen e sipërmarrësve të rinj në ndërtimin dhe zhvillimin e kompanive të reja.	www.jic-ks.com
Qendra e Kërkimit të Politikave të Sigurisë (SPRC)	Gjithë Kosova	Misioni i QKPS-së është të kryejë studime cilësore në fushën e sigurisë për Kosovën dhe rajonin e Ballkanit. SPRC, është një nën-përfitues i fondeve të GCERF dhe do të punojë në mënyrë aktive me komunitetet lokale në P/VE.	www.sprc-ks.org/
Iniciativa për Gruan e Kosovës (Kosovo Woman Initiative - KWI)	Rajoni i Dukagjinit	Përmirësimi i rolit të qytetarëve në vendimmarrje nëpërmjet projekteve dhe programeve për edukim dhe avokim, duke ndikuar kështu në qeverisjen më të mirë në Kosovë. KWI ka implementuar një projekt P/LEDH për rritjen e ndërgjegjësimit të prindërve në rajonin e Dukagjinit rreth rrezeve të P/LEDH.	Nuk vlen

Emri i organizatës	Fokusi gjeografik	Misioni	Ueb faqja
Qendra për Studime të Avancuara FIT	Gjithë Kosova	Misioni i organizatës është të përmirësojë pozitën e grupeve më të ndjeshme të shoqërisë, përmes hulumtimit, avokimit, edukimit dhe ngritjes së vetëdijes. Grupet kryesore cak të Qendrës FIT, janë fëmijët, të rinjtë, studentët, të moshuarit, gratë, të papunët, mjedisi etj. Qendra FIT është nën-pranuese e fondeve të GCERF dhe është partneri CDF-së në zbatimin e programit "BRICK". Qendra FIT zbaton aktivitete që synojnë të promovojnë përdorimin më të sigurt të internetit për fëmijët.	www.fit-ks.org
Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED)	Gjithë Kosova	Misioni i KIPRED-it është promovimi dhe konsolidimi i demokracisë dhe vlerave demokratike në Kosovë dhe në rajon përmes kërkimit të pavarur, zhvillimit të kapaciteteve dhe ndërtimit të institucioneve. KIPRED, është nën-përfituese e fondeve të GCERF dhe është pjesë e projektit "With Democracy Participating for a Kosovo without Radicalization" (Me pjesëmarrje demokratike për një Kosovë pa radikalizim).	www.kipred.org
Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (Advocacy Training and Resource Center - ATRC)	Gjithë Kosova	ATRC është një organizatë joqeveritare që punon në rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe shoqërisë civile në vendimmarrje, si parakusht për një shoqëri demokratike të zhvilluar dhe stabilitet rajonal. ATRC është nën-përfituese e fondeve të GCERF dhe është pjesë e konzorciumit të OSHC-ve në kuadër të projektit "With Democracy Participating for a Kosovo without Radicalization" (Me pjesëmarrje demokratike për një Kosovë pa radikalizim).	www.advocacy-center.org
Këshilli Rinor i Kosovës (KRK)	Gjithë Kosova	Këshilli Rinor Kosovar (KRK), është një organizatë joqeveritare e OJQ-ve e themeluar për aktivizim të kosovarëve të rinj për t'iu përgjigjur problemeve të shkaktuara nga dëbimi masiv nga shtëpitë e tyre në Shqipëri në vitin 1999. KRK vepron për të ndërtuar një shoqëri civile përmes pjesëmarrjes së të rinjve, duke krijuar dhe mbështetur OJQ-të rinore dhe duke koordinuar udhëheqjen e tyre. KRK është nën-përfituese e fondeve të GCERF dhe është partneri CDF-së në zbatimin e programit "BRICK".	www.kyc-ks.org

Emri i organizatës	Fokusi gjeografik	Misioni	Ueb faqja
Democracy Plus (D+)	Gjithë Kosova	Qëllimi kryesor i D+ është mbështetja e vlerave demokratike dhe praktikave në lëminë e qeverisjes së mirë, sundimit të ligjit, zgjedhjeve dhe partive politike, çështjeve sociale dhe të drejtave të njeriut. D+ është nën-përfutuese e fondeve të GCERF dhe është pjesë e projektit "With Democracy Participating for a Kosovo without Radicalization" (Me pjesëmarrje demokratike për një Kosovë pa radikalizim).	www.dplus-ks.org
Qendra e Kosovës për Mbështetjen e Biznesit (Kosovo Center for Business Support - KCBS)	Gjithë Kosova	Qëllimi i OJQ-së është të mbështesë rritjen ekonomike në fusha dhe sektorë të ndryshëm, të cilat janë jetike për rritjen e ekonomisë së Kosovës. KCBS është nën-përfutuese e fondeve të GCERF dhe është pjesë e projektit "With Democracy Participating for a Kosovo without Radicalization" (Me pjesëmarrje demokratike për një Kosovë pa radikalizim). Fokusi i KCBS-së do të jetë të sigurojë trajnim në ndërmarrësi për të rinjtë.	www.kcbs-ks.org
S'bashku	Prishtinë	S'bashku është një klub i studentëve në kuadër të Institutit Rochester të Teknologjisë në Kosovë (RIT-K) i krijuar për të zhvilluar mesazhe kundër ekstremizmit të dhunshëm.	Nuk vlen
Community Building Mitrovica (Ndërtimi i Komunitetit Mitrovicë)	Gjithë Kosova	Community Building Mitrovica (CBM), është një organizatë joqeveritare lokale (OJQ) që vepron në lëminë e paqes dhe ndërtimit të komuniteteve në rajonin më të gjerë të Mitrovicës, në komunat veriore të Kosovës. Qëllimi i përgjithshëm i CBM është të mundësojë kontaktet dhe dialogun ndërmjet qytetarëve në tërë komunën e Mitrovicës. CBM është përfutuesi kryesor i fondeve të GCERF dhe do të zbatojë aktivitetet që synojnë P/LEDH në rajonin e Mitrovicës.	www.cbmitrovica.org
INTEGRA	Nuk vlen	Integra punon drejtpërsëdrejti me përfutuesit dhe partnerët me mision të njëjtë në Kosovë dhe në rajon, për t'u mundësuar hisedarëve dhe akterëve që të zhvillojnë përgjigje të fuqishme përballë sfidave emergjente. Integra është nën-përfutuese e fondeve të GCERF dhe është partner i CDF-së në zbatimin e programit "BRICK".	www.ngo-integra.org

Emri i organizatës	Fokusi gjeografik	Misioni	Ueb faqja
Qendra Inovative e Kosovës (Innovation Centre Kosovo - ICK)	Gjithë Kosova	Frymëzon sipërmarrës që të vihen në vepër. Me njohuritë, shkathtësitë dhe përkushtimin e tyre, ICK ka misionin të zhvillojë një kulturë të inovacionit në Kosovë. ICK është nën-përfituese e fondeve të GCERF dhe është partneri i CDF-së në zbatimin e programit "BRICK", duke promovuar një mentalitet të ndërmarrësisë së të rinjve në Kosovë.	www.ickosovo.com
Shoqata e projekteve ndërkulturore - Kosovë (Cross Cultures Project Association – Kosovo - CCPA)	Nuk vlen	Shoqata e projekteve ndërkulturore (CCPA), u themelua në shkurt të vitit 1999, si një organizatë e pavarur ndërkombëtare jofitimprurëse, e cila ekziston me qëllim të zhvillimit, pjesëmarrjes dhe realizimit të projekteve që tejkalojnë linjat kulturore dhe që kanë si objekt kryesor promovimin e pajtimit, integrimit social dhe pjesëmarrjes së shoqërisë civile, përmes dialogut dhe bashkëpunimit. CCPA Kosovë është nën-përfituese e fondeve të GCERF dhe është partneri i CDF-së në zbatimin e programit "BRICK".	www.ccpa.eu/countries/kosovo
Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Humtuese (Balkan Investigative Reporting Network - BIRN)	Gjithë Kosova	BIRN, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Humtuese, është një rrjet i organizatave joqeveritare lokale që promovojnë lirinë e fjalës, të drejtat e njeriut dhe vlerat demokratike. BIRN është nën-përfituese e fondeve të GCERF dhe partnere e ATRC-së për zbatimin e projektit "With Democracy Participating for a Kosovo without Radicalization" (Me pjesëmarrje demokratike për një Kosovë pa radikalizim).	www.birn.eu.com
MUNDËSIA	Regjioni i Mitrovicës	Mundësia është një organizatë e shoqërisë civile që synon të përmirësojë situatën e grupeve të marginalizuara në Kosovë. Mundësia është nën-pranuese e fondeve të GCERF, në konsorciumin e udhëhequr nga Community Building Mitrovica.	Nuk vlen

Aneksi II

- Përkufizimet

Duke pasur parasysh se terminologjia rreth ekstremizmit të dhunshëm dhe parandalimit mund të jetë hutuese dhe problematike – shprehjet shpesh politizohen dhe përdoren pa dallim, shpesh pa ndonjë përkufizimit të qartë, e që për pasojë ka përdorimin e shprehjeve të njëjta për të përshkruar qasje të ndryshme – për qëllime të këtij krijimi të hartës, janë përdorur përkufizimet nga Këshilli Regjional për Bashkëpunim si pjesë e Platformës Regjionale për Luftimin e Radikalizimit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm që shpie në Terrorizëm dhe Rekrutim të Luftëtarëve të Huaj Terrorist:

i. Ekstremizmi i dhunshëm (EDH): Emri për dukurinë ku njerëzit apo grupe të njerëzve, në ndjekje të qëllimeve të tyre ideologjike, shfaqin gatishmërinë për të përdorur dhunën si pasojë e mënyrës së tyre ekstremiste të të menduarit; përdorimi i dhunës në ndjekje të qëllimeve politike; procesi i kthimit të mendimeve ekstremiste/radikale (politike, fetare apo ideologjike) në veprime të dhunshme.

ii. Parandalimi dhe luftimi i ekstremizmit të dhunshëm (P/LEDH): përdorimi i mjeteve jo detyruese në kërkim të shtytësve apo shkaqeve rrënjësore të ekstremizmit të dhunshëm. Sipas UNDP-së, “zakonisht mund të bëhet dallim me PEDH, i cili përqendrohet në parandalimin e përhapjes së mëtejshme të ekstremizmit të dhunshëm. Mirëpo, në praktikë, nismat shpesh funksionojnë në të dy aspektet, me një qasje të kombinuar. Ky vlerësim i gjendjes në terren përfshin OShC-të të cilat, ndër të tjera, punojnë në projekte të cilat vlerësohen apo përshkruhen si “CVE”, “PVE”, ose “P/CVE”.

Përkufizimet relevante shtesë:

OShC-të specifike për P/LEDH: OShC-të e cekura në vlerësimin e gjendjes duhet të klasifikohen si OShC specifike për P/LEDH, kur angazhohen në veprimtari vijuese: parandalimi dhe luftimi i ekstremizmit të dhunshëm, deradikalizimi, shkëputja dhe reintegrimi, kundër-narrativi dhe kundër-mesazhet, si dhe ngritja e aftësisë ripërtërirëse të komunitetit ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Aktivitetet e këtylla zakonisht dizajnohen me qëllim taksativ të zvogëlimit të ekstremizmit të dhunshëm apo rritjes së aftësisë ripërtërirëse kundër tij.

De-radikalizimi: procesi shoqëror dhe psikologjik përmes të cilit zvogëlohet përkushtimi dhe përfshirja e një individi ndaj ekstremizmit të dhunshëm deri në masën ku ata nuk përfaqësojnë më rrezik të përfshirjes në veprimtari të dhunshme, gjegjësisht, refuzon ideologjinë ose besimin shtytës të dhunshëm si dhe zotimin për të përdorur dhunë për të avancuar ideologjinë ose besimin e tillë. De-radikalizimi gjithashtu mund t'i referohet një iniciative e cila përpiqet të arrijë reduktimin e rrezikut nga ripërsëritja, përmes shtjellimit të çështjeve specifike

dhe relevante të shkëputjes. De-radikalizimi nënkupton një ndryshim, tjetër nga ai i ndërlidhur me vetë shkëputjen: ai nënkupton ndryshim në nivel konjitiv, jo thjeshtë ndalim fizik i sjelljes së dukshme.

Shkëputje: procesi përmes të cilit një individ përjeton ndryshim në rol apo në funksion i cili zakonisht ndërlidhet me uljen e pjesëmarrjes së dhunshme – gjegjësisht, heqje dorë nga dhuna por jo edhe nga ideologjia apo besimi. Kjo nuk nënkupton domosdo braktisjen e organizatës apo lëvizjes së ekstremizmit të dhunshëm. Gjithashtu, e tërë shkëputja mund të rrjedh nga ndryshimi i rolit, ndërsa ky ndryshim i rolit mund të ndikohet nga faktorët psikologjik, siç janë zhgënjimi, djegia, apo mos përmbushja e pritjeve të cilat shkaktuan përfshirjen fillestare. Kjo mund të bëjë që pjesëtari të kërkojë rol apo role të tjera përbrenda lëvizjes.

Reintegrimi: procesi përmes të cilit një “luftëtar i huaj terrorist” (LHT) apo ish-ekstremisti i dhunshëm, për të cilin besohet se nuk paraqet rrezik për sigurinë, i ofrohet mbështetje psiko-sociale, shkollim, punësim, apo trajnim për të lehtësuar ripërfshirjen e tyre në komunitet nga ku kanë dalur apo nga ndonjë komunitet tjetër përkatës.

Kundër-narrativi/mesazhet: mesazhet që ofrojnë një mendim alternativ ndaj rekrutimit dhe propagandës ekstremiste. Mesazhet mund të ofrojnë një ndihmë apo shteg alternativ për regrut të mundshëm, të cilët kërkojnë udhëzim apo kuptim. Mesazhi i kundër-narrativit gjithashtu mund të synojë zbrëthimin e narrativit ekstremist dhe ekspozimit të mangësive në logjikën e tyre.

Aftësia ripërtërirëse e komunitetit: aftësia e komunitetit që ta përballojë, t'i përgjigjet apo të rimëkëmbet nga një gamë e gjerë e ngjarjeve të dëmshme apo negative. [Shënim: varësisht nga dizajni/caku i programit për “aftësinë ripërtërirëse të komunitetit”, këto përpjekje mund të kategorizohen si specifike për P/LEDH apo relevante për P/LEDH.]

Relevante për P/LEDH: OShC-të e listuara në hartë klasifikohen si relevante për P/LEDH kur janë të përfshira në aktivitete të cilat në mënyrë indirekte adresojnë shtytësit e ekstremizmit të dhunshëm përmes: fuqizimit të rinisë apo të grave, sundimit të ligjit, kundër korrupsionit, përfshirjes qytetare, të drejtave të njeriut, demokracisë, qeverisjes së mirë, aftësimin profesional, shkollimit, krijimit të besimit dhe përfshirjes së komunitetit, si dhe zgjidhjes së konfliktit. Aktivitetet relevante për P/LEDH janë ato, qëllimi i të cilave është jo të parandalojnë apo të luftojnë ekstremizmin e dhunshëm, por të cilat sërish i kontribuojnë ngritjes apo krijimit të aftësisë së ripërtërirëse kundër ekstremizmit të dhunshëm.

PËR PROJEKTIN

Komunitetet në rend të parështë platformë regjionale e shoqërisë civile të Ballkanit Perëndimor për P/LEDH, udhëhequr nga konzorciumi i gjashtë organizatave jo-qeveritare nga Mali i Zi, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia, dhe Serbia. Kjo iniciativë tre-vjeçare përqendrohet në nxitjen e bashkëpunimit kombëtar apo regional ndërmjet OShC-ve lokale, organizatave fetare, si dhe aktivistëve të komunitetit, të përfshirë në P/LEDH. Qëllimi i programit është t'i fuqizojë këta akterë, të rris kapacitetin e tyre, të përmirësojë efikasitetin dhe llogaridhënien si dhe t'u mundësojë të bëhen ndikues më efektiv të politikave relevante të P/LEDH.

Aktivitetet përfshijnë: krijimin e hartës së programeve dhe nismave të P/LEDH, të prirë nga OSHC-të; zhvillimi i qendrës online për OSHC-të për shkëmbim të praktikave të mira, resurseve dhe bashkëpunimit më të madh regional; ngritja e kapacitetit dhe programet e mentorimit; dhe themelimi dhe realizimi i programeve të granteve të vogla.

Partners Kosova (PK) në konzorcium me pesë OJQ -ët e lartpërmendura është duke zbatuar projektin **“Komunitetet në rend të parë- Krijimi i qendres të shoqërisë civile për adresimin e Extremizmit të Dhunshëm- Nga Parandalimi deri në Reintegrimit.”**

Si një anëtare e Partners Global (Rrjetit Global të Partnerëve) të njëzet organizatave të pavarura lokale në botë, Partners Center for Conflict Management është e themeluar në vitin 2001, si një OJQ nën menaxhim lokal, PK ka përvojë 17 vjeçare të punës në avancimin e shoqërisë civile, qeverisjes së mirë dhe kulturës së ndryshimit, paqes dhe menaxhimit të konfliktit në Kosovë, BE dhe më gjerë – në nivel global.

Që nga viti 2016, Partners Kosova ishte ndër OJQ-të e para për zbatimin e disa projekteve të P/LEDH në bashkëpunim me qeverinë qendrore dhe lokale, si dhe me hisedarë ndërkombëtarë – organizata dhe donatorë që përqendrohen në parandalimin e përhapjes së mëtejme të veprimtarive të ekstremizmit të dhunshëm. PK është e përkushtuar të vazhdojë punën në parandalim përmes fushatave të vetëdijesimit dhe të edukimit, trajnimeve, tryezave të rrumbullakëta, mesazheve, etj., teksa punon me institucione qeveritare dhe komunitetin e biznesit për të krijuar vende të punës si formë e integritit të tyre. Ueb faqja: <http://www.partnerskosova.org> në ndërtim e sipër, dhe Facebook <https://www.facebook.com/partnerskosova/>

PËR AUTORIN:

Anil Gashi përfundoi studimet në nivelin Bachelor në Rochester Institute of Technology në Kosovë dhe ka ndjekur programin e certifikimit pasuniversitar në Leadershipin në Arsim dhe Analizën e Politikave në Universitetin e Missouriit në Kolumbia të SHBA-ve. Në mars të vitit 2015, z. Gashi është bërë pjesë e Qendrës për Studime të Avancuara FIT ku shërben si menaxher i projekteve. Gjatë kohës së tij në Qendrën FIT, z. Gashi ka menaxhuar projekte të ndryshme të përkrahura nga Ambasada Amerikane në Prishtinë, Save the Children, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), Qendra Kosovare për Arsim, dhe Fondacioni Evropian për Demokraci me bazë në Bruksel. Z. Gashi është autor i disa botimeve, përfshirë studimin hulumtues “Siguria e Fëmijëve në Internet” që është raport unik i cili bën vlerësimin e sjelleve të fëmijëve në botën virtuale. Z. Gashi ka qenë pjesëmarrës në programin e shkëmbimit profesional të Departamentit Amerikan të Shtetit: International Visitor Leadership Program (IVLP), dhe poashtu është përfitues i bursës Transformational Leadership Program (TLP) nga USAID.

